

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Kuvendi Koomunal Fushë Kosovë

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 612-26-3221-1-2-1

Sa i përket tenderit për: Blerja e një Autoambulane për nevojat e QKMF-së,

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj: OMI Engineering LLC

NUI : 811274894

Adresa : Motrat Qiriazi, nr.17

Vendi Kodi postar : 12,000, Fushë Kosovë

Numri Telefonit : +383 45 253 981

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj

: Enver Tërnavë

Adresa elektronike

: omiengineeringks@gmail.com

Data e parashtrimit të ankesës

: 07.07.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

*Shëno të dhënat si në vijim: **S'ka Avokat te autorizuar***

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo

“Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ky aktivitet i prokurimit ka filluar me rastin e njoftimit për kontratë i cili është bërë më datën: 07.05.2026. Me dt.18.05.2026, Vendimin e Ak-së për refuzimin e kërkesës së OE- Euroint, ku vetë AK e mbron kriterine që autoambulanca të jete fabrikishte e prodhuar sipas **standarteve EN 1789**. Hapja publike është bërë më datë: 01.06.2026, ora 13:30., ashtu siç ka qenë e paraparë me njoftimin për kontratë.

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së është bërë me datën: **15.06.2026**. Të pakënaqur me këtë Vendim dhe brenda afatit të rregullte kohorë, ne kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues.

AK pas shqyrtimit të kërkesës tonë, më datë: 29.06.2026, na e kthen përgjigjen duke marr vendim për refuzim të kërkesës tonë si të pabazuar. Arsyetimi i dhënë nga AK nuk është i qëndrueshëm dhe real si dhe veprimet administrative nuk janë në përputhje me LPP-në dhe RRUOPP-në andaj ne i drejtohem OSHP-së me këtë ankesë.

Kriteri i vlerësimit ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët**.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Ne nuk kemi marrë pjesë në hapjen publike sepse tashmë bëhet përmes sistemit të e-prokurimit. Gjatë hapjes publike nuk ishte evidentuar ndonjë parregullsi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së është bërë me datën: 15.06.2026. Të pakënaqur me këtë Vendim dhe brenda afatit të rregullte kohorë me datë: 20.06.2026, ne kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues.

AK pas shqyrtimit të kërkesës tonë, më datë 29.06.2026, na e kthen përgjigjen duke marr vendim për refuzim të kërkesës tonë si të pabazuar. Arsyeimi i dhënë nga AK nuk është i qëndrueshëm dhe real si dhe nuk është në përputhje as me LPP dhe RRUOPP andaj ne i drejtohem OSHP-së me këtë ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK gjatë zhvillimit të kësaj procedure të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

- 1. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së,**
- 2. AK ka shkelur nenin 28 të LPP-së,**
- 3. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së,**
- 4. AK ka shkelur nenin 65 të LPP-së dhe 45.3 të RRUOPP**

Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 1% të shumës 898.65 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

e vazhdim po ju njohim me faktet dhe argumentet qe e mbështesin pretendimin tonë për shkeljet e dispozitave të LPP-së nga ana e AK-së.

Pretendimi -I- : AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së gjatë procesit të vlerësimit të ofertave pasi që mos respektimi i kërkesave nga dosja e tenderit e shtynë atë drejt trajtimit jo të barabartë të tenderuesve.

Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar operatorin ekonomik **ES-Industry Sh.P.K.**, ndonëse oferta e tij nuk përmbush kërkesat e detyrueshme të Dosjes së Tenderit. Vendimi është në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, me Dosjen e Tenderit dhe me parimet e transparencës, barazisë dhe konkurrencës së ndershme.

Pretendimi II :

AK ka përdorur dy standarde të ndryshme

Kjo është shkelja më e rëndë. Gjatë fazës së tenderimit OE **Euroint Sh.P.K.** kërkoi të hiqej kriteri:

“Automjeti duhet të jetë i prodhuar fabrikisht si autoambulancë.”

AK Komuna e Fushë Kosovës e refuzoi kërkesën.

Në arsyetim deklaroi se: ky kriter është i domosdoshëm, është vendosur për sigurinë e pacientëve, garanton cilësinë nuk do të ndryshohet. Por më vonë, gjatë vlerësimit të ofertave, AK shpalli fitues OE **ES-Industry Shpk**, edhe pse ai nuk provoi të njëjtin kriter. Pra:

Në fazën e sqarimeve kriteri ishte i detyrueshëm.

Në fazën e vlerësimit kriteri u injorua. Ky është trajtim i pabarabartë.

Pretendimi III. SHKELJA E DYTË

ES-Industry nuk ka provuar se autoambulanca është Factory Built

Dosja e tenderit nuk kërkon deklaram. Dosja kërkon:

“Automjeti duhet të jetë i prodhuar fabrikisht si autoambulancë ”

Operatori fitues nuk ka dorëzuar:

Certifikatë të prodhuesit, Deklaratë të prodhuesit, Homologim, Dokument teknik, Certificate of conformity,

Asnjë dokument nga fabrika.

Ka dorëzuar vetëm: vetëdeklarim. Vetëdeklarimi nuk është provë. Një operator ekonomik nuk mund të vërtetojë vetë karakteristikat teknike të produktit të prodhuar nga një fabrikë.

Pretendimi IV. SHKELJA E TRETË

Mungon EN 1789 Nëse kërkohet EN1789, ES-Industry nuk ka dorëzuar:

Certifikatën, deklaratë nga organi certifikues, dëshmi të vlefshme. Prandaj nuk është provuar përputhshmëria me standardin.

Pretendimi V. SHKELJA E KATËRT

Dy çmime të ndryshme Në ofertën e ES-Industry ekzistojnë dy çmime.

AK nuk e ka analizuar fare këtë mospërputhje është mjaftuar perseri me “deklarate gabim tekik”

Kjo cenon transparencën dhe barazinë.

Pretendimi VI. SHKELJA E PESTË

AK nuk ka bërë verifikimin e dokumenteve. Komisioni është mjaftuar me vetëdeklarimin. Nuk ka kërkuar: dokumente të prodhuesit, homologim, certifikata. Pra nuk ka bërë verifikimin që kërkon LPP.

VII. SHKELJA E GJASHTË

Vendimi është i paarsyetuar AK nuk tregon:

cili dokument provon prodhimin fabrikisht, cili dokument provon EN1789, cili dokument provon se autoambulanca nuk është Furgon i modifikuar. Vendimi përmban vetëm konstatime. **Jo prova.**

Pretendimi VIII. PËRFUNDIMI

Autoriteti Kontraktues: ka mbrojtur kriterin gjatë tenderimit më pas nuk e ka zbatuar, ka rekomanduar operator që nuk ka prova, ka shkelur LPP, ka shkelur Dosjen e Tenderit; ka shkelur barazinë e operatorëve ekonomikë. Veprimet e tilla janë në kundërshtim të plotë me nenin 59 të LPP-së si dhe me nenin 44 të RRUOPP-së.

AK favorizon OE e shpallur fitues duke i pranuar ndryshimet në çmim dhe vetëdeklarata për dokumentacion që në asnjë formë ligji dhe rregullorja nuk e lejojnë pranimin e tyre.

Kjo tregon qartë se AK përkatësisht komisionin i vlerësimit dhe Zyra e Prokurimit në përgjithësi kanë tendencë të hapura për ta shpallur gjithsesi fitues OE që e kanë përzgjedhë në mënyre jo të drejtë dhe ligjore. E gjithë kjo tregon qartë se AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që hapur po shihet se ka favorizuar OE që e ka shpallur fitues ndërsa na ka diskriminuar neve në mënyrën më jo normale duke nxjerrur vendime kontroverse nga Zyra e Prokurimit me veprime administrativisht të kundërligjshme dhe vendime të gabuara.

Krejt kjo tregon qartë se AK ka bërë favorizim dhe diskriminim të OE konkurrent duke shkelur plotësisht nenin 7 të LPP-së.

AK ka shkelur nenin 28 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk është siguruar se OE i shpallur fitues ka dorëzuar specifikimin teknik ashtu siç e kishte kërkuar AK me dosjen e tenderit përkatësisht me Aneksin 1. AK e ka obligim që duke u bazuar në nenin 28 të sigurohet se specifikimi i shërbimeve i ofruar nga OE të jetë i njëjtë me atë që e ka kërkuar AK e që në rastin konkret kjo nuk ka ndodhur pasi që Aneksi 1 i dorëzuar nga OE fitues ndryshon nga ai i kërkuar nga AK.

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk i ka aplikuar drejtë kërkesat e përcaktuara paraprakisht në dosjen e tenderit aneksi 1 specifikimi teknik i detyrueshem dhe në njoftimin për kontratë.

Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ndërsa Aneksi 1 i nënshkruar dhe vulosur që kishte ofruar OE i shpallur fitues duket kështu:

Me detajisht shish pershkrimin e cmimit nga OE Es Industry.

Idet	Emri i artikullit	Numri dhe përshkrimi i artikullit (nëqytetë të funksionimit përveç)	Preca
132	132	132	132
133	133	133	133
134	134	134	134
135	135	135	135
136	136	136	136
137	137	137	137
138	138	138	138
139	139	139	139
140	140	140	140
141	141	141	141
142	142	142	142
143	143	143	143
144	144	144	144
145	145	145	145
146	146	146	146
147	147	147	147
148	148	148	148
149	149	149	149
150	150	150	150
151	151	151	151
152	152	152	152
153	153	153	153
154	154	154	154
155	155	155	155
156	156	156	156
157	157	157	157
158	158	158	158
159	159	159	159
160	160	160	160
161	161	161	161
162	162	162	162
163	163	163	163
164	164	164	164
165	165	165	165
166	166	166	166
167	167	167	167
168	168	168	168
169	169	169	169
170	170	170	170
171	171	171	171
172	172	172	172
173	173	173	173
174	174	174	174
175	175	175	175
176	176	176	176
177	177	177	177
178	178	178	178
179	179	179	179
180	180	180	180
181	181	181	181
182	182	182	182
183	183	183	183
184	184	184	184
185	185	185	185
186	186	186	186
187	187	187	187
188	188	188	188
189	189	189	189
190	190	190	190
191	191	191	191
192	192	192	192
193	193	193	193
194	194	194	194
195	195	195	195
196	196	196	196
197	197	197	197
198	198	198	198
199	199	199	199
200	200	200	200
TOTALI			89500.00

Pra po shihet se kriter ne shenimin: **Vërejtje automjeti duhet te jenete fabrikishte si autoambulance.** Standarti i dyfishtë Cmimi: 89,500.00euro i dyshimt e i ndryshuar ne 88.800,00euro.

Autoriteti Kontraktues ka qenë i detyruar ta shpallë të papërgjegjshëm operatorin ekonomik ES Industri, sepse ky nuk ka provuar me dokumente të vlefshme, të qarta dhe të verifikueshme se automjeti i ofertuar është autoambulancë e prodhuar në fabrikë dhe e certifikuar sipas standardit EN 1789. Në vend të provës objektive, ES Industri është mbështetur kryesisht në vetëdeklarim dhe në dokumente të përgjithshme që nuk e dëshmojnë përmbushjen e kërkesës thelbësore të tenderit. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues e ka shpërblyer me kontratë, në kundërshtim me ligjin dhe me parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Mosrespektimi i specifikimeve teknike

Dosja e tenderit ka kërkuar që autoambulanca të jetë e prodhuar në fabrikë si autoambulancë, e jo një furgon bazë i përshtatur më vonë për përdorim emergjent. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me sigurinë, funksionalitetin dhe certifikimin teknik të automjetit.

Oferta e ankuesit e përmbush këtë kërkesë, pasi është shoqëruar me dokumentacion të plotë që provon se automjeti është autoambulancë e prodhuar në fabrikë, e certifikuar sipas EN 1789 dhe e mbështetur nga dokumente teknike, ateste dhe deklarata konformiteti të prodhuesit. Këto prova tregojnë se automjeti është ndërtuar si autoambulancë që në fazën e prodhimit, e jo i konvertuar pas prodhimit bazë.

Në anën tjetër, oferta e ES Industri nuk e dëshmon këtë nivel përputhshmërie. Dokumentacioni i saj tregon vetëm një automjet bazë të modifikuar, pa certifikatë të vlefshme EN 1789 dhe pa prova të barasvlershme që të vërtetojnë prodhim fabrikor si autoambulancë. Vetëdeklarimi dhe dokumentet e përgjithshme nuk mjaftojnë për të përmbushur kërkesën e tenderit.

Rëndësia e standardit EN 1789

EN 1789 është standardi evropian që përcakton kërkesat teknike dhe të sigurisë për autoambulanat dhe pajisjet e tyre mjekësore. Ai nuk është formalitet administrativ, por garanci se automjeti është i përshtatshëm për transport dhe trajtim emergjent të pacientëve.

Ky standard përfshin, ndër të tjera, ndërtimin e autoambulancës si automjet i posaçëm, sigurinë strukturore të kabinës mjekësore, fiksimin dhe testimin e pajisjeve, mbrojtjen e pacientit dhe personelit, si dhe testet e rezistencës dhe funksionalitetit të hapësirës së trajtimit.

Prandaj, certifikata EN 1789 e paraqitur nga ankuesi është provë vendimtare e përmbushjes së kërkesës së tenderit. Në mungesë të kësaj certifikate, ose të një dokumenti ekuivalent të vlefshëm, oferta e ES Industri

mbetet e paprovuar në aspektin teknik.

Lidhja e pretendimeve me provat përkatëse

Pretendimi ynë mbështetet në dokumente konkrete dhe në mundësinë e provës së mjaftueshme nga ana e ES Industri:

1. Për ofertën e ankuesit Omi Engineering LLC
 - Certifikata EN 1789 dëshmon se autoambulanca është e certifikuar sipas standardit evropian.
 - Dokumentet e prodhuesit dhe katalogët teknikë tregojnë se automjeti është projektuar dhe prodhuar si autoambulancë.
 - Certifikatat, atestet dhe dokumentet mbështetëse dëshmojnë përputhshmërinë e komponentëve teknikë dhe të pajisjeve mjekësore me kërkesat e tenderit.
 - Dokumentacioni i plotë teknik vërteton se automjeti nuk është i konvertuar, por i ndërtuar si autoambulancë që në prodhim.
2. Për ofertën e ES Industri
 - Dokumentet teknike tregojnë se baza e ofertës është një furgon standard.
 - Mundësia e certifikatës EN 1789 ose e një dokumenti ekuivalent e bën ofertën të paplotë teknikisht.
 - Mundësia e provës për prodhim fabrikor si autoambulancë tregon se automjeti është vetëm i modifikuar pas prodhimit bazë.
 - Vetëdeklarimi, edhe kur shoqërohet me disa dokumente të përgjithshme, nuk përbën provë të mjaftueshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e kërkesës së tenderit.
 - Dokumentacioni i konvertimit, nëse është paraqitur, nuk e zëvendëson certifikimin e kërkuar dhe nuk e barazon një furgon të përshtatur me një autoambulancë të prodhuar në fabrikë.

Dallimet teknike mes ofertave

Dallimi mes ofertës së ankuesit dhe asaj të operatorit fitues është thelbësor:

- Ankuesi ka ofertuar autoambulancë të prodhuar në fabrikë, me certifikim EN 1789 dhe dokumentacion të plotë teknik.
- ES Industri ka ofertuar furgon të modifikuar, pa provuar se automjeti është prodhuar si autoambulancë dhe pa dokumentacion certifikues të mjaftueshëm.

Ky dallim është vendimtar, sepse një automjet i modifikuar nuk ka të njëjtin nivel sigurie strukturore, nuk garanton të njëjtën cilësi të integritetit të pajisjeve mjekësore dhe nuk dëshmon përputhje të plotë me kërkesat e EN 1789. Për këtë arsye, oferta e ES Industri nuk mund të konsiderohet e përgjegjshme në kuptim të ligjit.

Rrezikimi i interesit publik

Vendimi i Autoritetit Kontraktues nuk cenon vetëm rregullat e prokurimit publik, por krijon edhe rrezik për interesin publik. Autoambulancat përdoren për transportimin e pacientëve në gjendje kritike, prandaj çdo devijim nga standardet e detyrueshme të sigurisë mund të ndikojë drejtpërdrejt në jetën dhe shëndetin e pacientëve dhe të personelit mjekësor.

Praktika e mëparshme

Vlen të theksohet se i njëjti operator ekonomik ka qenë subjekt i kontestimeve edhe në një procedurë të mëparshme për furnizim me autoambulanca. Edhe pse ky fakt nuk përbën provë për këtë rast, ai e bën edhe më të domosdoshëm një kontroll rigoroz mbi dokumentacionin certifikues dhe provat teknike të paraqitura në këtë tender.

Nisur nga krejt kjo del që veprimi i AK karshi tenderit tonë është plotësisht diskriminues dhe i kundërligjshëm duke shkelur dispozitat e LPP-ës lidhur me administrimin e drejt të procedurave të prokurimit dhe duke shkelur nenin 59 të LPP-së dhe nenin 41 të RRUOPP-së

Pas krejt kësaj që u tha për veprimet dhe mosveprimet e AK-së shihet se AK gjatë procesit të vlerësimit dhe gjatë administrimit me procedurën pas përfundimit të procesit të prokurimit, ka shkelur plotësisht nenin 59 të LPP-së dhe nenin 41 të RRUOPP-së dhe dispozitat ligjore që flasin për administrimin e drejtë të procedurave të prokurimit.

AK ka shkelur nenin 65 të LPP-së dhe nenin 45 të RRUOPP-së pasi që gjatë vlerësimit nuk i ka trajtuar mirë dokumentacionet që janë dorëzuar nga OE që më pas e ka shpallur fitues.

Mos trajtimi i drejt i këtyre mangësive të ofertës së OE të shpallur fitues, e shtynë AK-në drejt shkeljes së dispozitave ligjore lidhur me vlerësimin e tenderëve sipas kërkesave të dosjes së tenderit, LPP-së dhe RRUOPP-së. Detajet e këtyre mangësive i gjeni tek pretendimi i mësipërm.

Bazuar në krejt këtë që theksuam më lart kërkojmë nga OSHP që të merr:

V E N D I M

KËRKESA NDAJ OSHP-së Kërkojmë që Paneli Shqyrtues:

Të konstatojë se oferta e ES-Industry nuk është ofertë e përgjegjshme pasi nuk provon se autoambulanca është **Factory Built Ambulance** sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit

APROVOHET si e bazuar ankesa e OE - **OMI Engineering LLC**, lidhur me tenderin: Blerja e një Autoambulane për nevojat e QKMF-së i iniciuar nga Kuvendi Koomunal Fushë Kosovë

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK- Kuvendi Koomunal Fushë Kosovë për shpallje si fitues të Operatorëve Ekonomik: Es – Industry Shpk dhe lënda të kthehet në **RI-VLERËSIM**.

Të konstatojë se oferta e ES-Industry nuk është ofertë e përgjegjshme pasi nuk provon se autoambulanca është **Factory Built Ambulance** sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Ri-vlerësimi të bëhet bazuar plotësisht në kërkesat e dosjes së tenderit dhe të LPP-së ku më pas do duhej që **Fitues** të shpallej OE “ **OMI Engineering** ” LLC.

9. Dëmet materiale














Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë. Po ashtu kemi edhe dëmtim të reputacionit si një kompani serioze,

me një përvojë të madhe në këtë fushë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

 3 ES Deklarate e perputhshmerise	6/16/2026 8:44 AM	Microsoft Edge PD...	164 KB
 5 ES_Katallogu-1-41	6/16/2026 8:44 AM	Microsoft Edge PD...	9,908 KB
 6 ES Katallogu i vetures	6/16/2026 8:44 AM	Microsoft Edge PD...	6,036 KB
 Autoambulanca -Paramamsat dhe specifi...	7/7/2026 9:06 PM	Microsoft Excel W...	21 KB
 B05 Njoftim per Kontrat	7/5/2026 9:29 PM	Microsoft Edge PD...	143 KB
 B54 Formulari standard per korrjgimin e ...	7/5/2026 9:29 PM	Microsoft Edge PD...	105 KB
 Dorzimi i tenderit nga OE ES Industry 8f...	6/16/2026 8:44 AM	Microsoft Edge PD...	110 KB
 Dosja e Tenderit-Ambulanca	7/5/2026 9:31 PM	Microsoft Word D...	151 KB
 EC DECLARATION EN 1789_compressed	6/1/2026 11:40 AM	Microsoft Edge PD...	13,609 KB
 Kërkesë për rishqyrtim - Kerkese per rish...	6/20/2026 2:07 PM	Microsoft Edge PD...	108 KB
 Leter standarte mbi eliminimin e tender...	7/5/2026 9:36 PM	Microsoft Edge PD...	2,420 KB
 Refuzimi per Euroint Shpk 18.05.2026	7/5/2026 9:31 PM	Microsoft Edge PD...	2,479 KB
 Vendim mbi refuzim Omit	7/7/2026 1:41 AM	Microsoft Edge PD...	2,880 KB

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, originalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*